

PARTIA DEMOKRATIKE  
DEGA PATOS

Roskovec, më 17 /03/2021

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** Parta Demokratike Dega Patos

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale , *Neni 258 "Shkelja e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike"*.

**KUNDER:** [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR]

**DREJTUAR:** Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier  
**PËR DIJENI :** SPAK TIRANË

*I nderuar Z. Prokuror,*

Bazuar në nenet 280, 283 dhe 75/a të K.Pr.Penale, si dhe neneve 258 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHEM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dijani për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Çdo person që ka marrë dijani për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*